



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
DREJTORIA E ANALIZËS DHE METODOLOGJISË SË TREGJEVE

NJOFTIM

Rasti: Krijimi i një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, nga shoqëritë Daimler Truck AG, Traton International S.A dhe Volvo Energy AB.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është protokolluar shkresa nr.557 prot.i AK, datë 29.12.2021 “Përqendrimi ndërmjet Daimler Truck AG, Traton SE dhe Aktiebolaget Volvo”, me të cilën jemi njoftuar në lidhje me synimin e krijimit të një joint – venture me funksione të plota, nga shoqëritë Daimler Truck AG, Traton International S.A dhe Volvo Energy AB.

Referuar marrëveshjes, palët janë:

Pala 1: Daimler Truck AG, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e krijuar sipas ligjeve të Gjermanisë me objekt; veprimtari e drejtpërdrejtë ose e tërthortë në fushën e zhvillimit, prodhimit dhe shitjes së produkteve dhe ofrimit të shërbimeve, veçanërisht në sektorët e biznesit si: automjetet, motorët dhe mjetet teknike të të gjitha llojeve, produkte të tjera të inxhinierisë së qarkullimit rrugor etj.

Daimler Truck AG nuk ka prezencë ligjore të regjistruar në Shqipëri.

Pala 2: Traton International S.A është një shoqëri aksionare, e krijuar sipas ligjeve të Luksemburgut dhe objekti i shoqërisë është pjesëmarrje në shoqëri vendase dhe të huaja, ose shoqëri të çfarëdo lloji dhe menaxhim i këtyre pjesëmarrjeve etj. Traton International S.A është një degë e zotëruar plotësisht nga Traton SE, filial i zotëruar indirekt nga Grupi Volkswagen.

Grupi Volkswagen operon në Shqipëri përmes shoqërive të zotëruar indirekt prej tij: Porsche Albania SHPK dhe Porsche Leasing SHPK.

Pala 3: Volvo Energy AB është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas ligjeve të Suedisë, e cila ofron automjete dhe makineri elektrike për një sërë aplikimesh. Volvo Energy AB është një degë e zotëruar indirekt nga Aktiebolaget Volvo.

Grupi Volvo nuk ka ndonjë filial, degë apo zyrë përfaqësimi në Shqipëri.

Ndërmarrja e përbashkët (JV) do të themelohet si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas ligjeve të Hollandës. Ndërmarrja e Përbashkët do të përqendrohet në ndërtimin dhe operimin e një rrjeti karikimi të aksesueshëm nga publiku për kamionë të rëndë dhe autobusë me bateri elektrike.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al.